

VENDIM
Nr.1451, datë 5.11.2008

PËR DISA SHTESA NË VENDIMIN NR.478, DATË 18.7.2007 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR MIRATIMIN E STRUKTURËS DHE TË NIVELEVE TË PAGAVE
TË NËPUNËSVE TË DISA INSTITUCIONEVE, NË VARËSI TË MINISTRAVE TË
LINJËS”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 5/1 të ligjit nr.8487, datë 13.5.1999 “Për kompetencat për caktimin e pagave të punës”, të ndryshuar, dhe të nenit 8 të ligjit nr.9836, datë 26.11.2007 “Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2008”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Brendshëm dhe të Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr.478, datë 18.7.2007 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, të bëhen shtesat e mëposhtme:

a) Në pikën 5, pas togfjalëshit “...bordeve të kullimit...” shtohen “... si dhe komisionet vendore të shqyrtimit të vlefshmërisë ligjore të krijimit të titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore, pranë prefektit të qarkut...”.

b) Pas pikës 5/5 shtohet pika 5/6, me këtë përmbajtje:

“5/6. Struktura dhe nivelet e pagave të nëpunësve në pozicionet “Specialist” deri në “Titullar i institucionit”, në komisionet vendore të shqyrtimit të vlefshmërisë ligjore të krijimit të titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore, pranë prefektit të qarkut, të jenë sipas lidhjes nr.4/6, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.”.

c) Në pikat 6, 7, 8, 9 e 13, pas fjalëve “...nr.4/5.” shtohet “...nr.4/6.”.

3. Efektet financiare për vitin 2008, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga fondet shtesë, që do të miratohen për këto komisione, në buxhetin e Ministrisë së Brendshme.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Lidhja nr.4/6

STRUKTURA DHE NIVELET E PAGAVE TË NËPUNËSVE NË KOMISIONET
VENDORE TË SHQYRTIMIT TË VLEFSHMËRISË LIGJORE TË KRIJIMIT TË TITUJVE
TË PRONËSISË MBI TOKËN BUJQËSORE, PRANË PREFEKTIT TË QARKUT

Pozicioni	Kategoria	Paga individuale (paga bazë)			Shtesa e pozicionit	Shtesa për kushte pune
		1	2	3		
		Paga e grupit (PG)	Shtesa vjetore për vjetërsi (SHV)	Shtesa për kualifikim (SHK)	Shtesa e pozicionit (SHP)	
Titullar i institucionit pranë prefektit të qarkut: Durrës, Elbasan, Fier, Korçë, Lezhë,	III-a	11.000	2%		68.500	

Shkodër, Tiranë, Vlorë						
Titullar i institucionit pranë prefektit të qarkut: Berat, Dibër, Gjirokastrë, Kukës	III-b	11.000	2%		51.500	
Specialist në komisionet vendore pranë prefektit të qarkut: Durrës, Elbasan, Fier, Korçë, Lezhë, Shkodër, Tiranë, Vlorë	IV-a	11.000	2%		39.000	5.000
Specialist në komisionet vendore pranë prefektit të qarkut: Berat, Dibër, Gjirokastrë, Kukës	IV-b	11.000	2%		29.000	5.000